

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbështetje për gjallërimin e aktivitetit social kulturor në funksion të forcimit të identitetit rajonal dhe lokal, Faza II.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 79952000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 333,333,110 lekë pa TVSH ose 3,370,064.80 Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor FSHZH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas Shtojcës Nr. 9

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

22.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e

xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë të paktën 30% e vlerës së fondit limit.

Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës wshtw mbi kufirin e lartë monetar dhe e njw natyre specifike nw treg. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” Ky kriter është vendosur posaçërisht për të garantuar që operatorët ekonomikë aplikues posedojnë kapacitetet e duhura për të përballuar angazhime të qëndrueshme dhe me ngarkesa të larta financiare, të cilat mund të lindin nga një sipërmarrje afatgjatë. Në veçanti, kërkohet që operatorët të dëshmojnë që kanë jo vetëm eksperiencë, por edhe stabilitet të vazhdueshëm financiar, duke siguruar kështu që të jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale pa rrezik për ndonjë ndërprerje apo mangësi në ofrimin e shërbimeve.

Për më tepër, duke pasur parasysh natyrën afatgjatë të kontratës dhe periudhat e pikut sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues, është e domosdoshme që ofertuesit të ofrojnë prova të kapacitetit të tyre për të përballuar sfidat financiare dhe operationale që mund të vijnë me intensitet të shtuar dhe kërkesa të paparashikueshme. Kjo siguron jo vetëm qëndrueshmëri ekonomike, por edhe një nivel të lartë të profesionalizmit dhe përkushtimit, duke e vendosur ofertuesin si një aktor të besueshëm në sektorin përkatës.

Në këtë mënyrë, përmes këtij kriteri vërtetohet që operatorët jo vetëm janë në gjendje të përmbushin detyrimet e kontratës, por gjithashtu kanë një ndikim të qëndrueshëm në tregun e shërbimeve të kërkuara, duke ofruar një garanci më të lartë për cilësinë dhe përmbushjen e objektivave të kontraktimit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruar me Aktin e Ekspertizës së Autorizuar Kontabël, në rastet kur ato janë sipas përcaktimeve të nenit 41, pika “c”, të ligjit nr. . 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor,

organizimin e profesionit të auditorit ligjor dhe kontabilitetin e miratuar", 2) 2 vjet bilanc nuk duhet të kenë marrëdhënie negative midis aktiveve. dhe detyrimet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël". Ky kriter është vendosur posaçërisht për të garantuar që operatorët ekonomikë aplikues posedojnë kapacitetet e duhura për të përballuar angazhime të qëndrueshme dhe me ngarkesa të larta financiare, të cilat mund të lindin nga një sipërmarrje afatgjatë. Në veçanti, kërkohet që operatorët të dëshmojnë që kanë jo vetëm eksperiencë, por edhe stabilitet të vazhdueshëm financiar, duke siguruar kështu që të jenë në gjendje të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale pa rrezik për ndonjë ndërprerje apo mangësi në ofrimin e shërbimeve.

Për më tepër, duke pasur parasysh natyrën afatgjatë të kontratës dhe periudhat e pikut sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues, është e domosdoshme që ofertuesit të ofrojnë prova të kapacitetit të tyre për të përballuar sfidat financiare dhe operacionale që mund të vijnë me intensitet të shtuar dhe kërkesa të paparashikueshme. Kjo siguron jo vetëm qëndrueshmëri ekonomike, por edhe një nivel të lartë të profesionalizmit dhe përkushtimit, duke e vendosur ofertuesin si një aktor të besueshëm në sektorin përkatës.

Në këtë mënyrë, përmes këtij kriteri vërtetohet që operatorët jo vetëm janë në gjendje të përmbushin detyrimet e kontratës, por gjithashtu kanë një ndikim të qëndrueshëm në tregun e shërbimeve të kërkuara, duke ofruar një garanci më të lartë për cilësinë dhe përmbushjen e objektivave të kontraktimit.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së perlojaritur te fondit qe prokurohet

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit që do të thotë që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e larte monetary dhe me natyre te vecante. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin, vlerën e kontratës dhe kohezgjatjen.

Ky kriter është vendosur me qëllim të garantimit që operatorët ekonomikë të kenë jo vetëm personel të mjaftueshëm, por edhe të kualifikuar dhe të specializuar, të aftë për të realizuar me sukses kontratën. Kjo dëshmon që operatorët kanë përvojën dhe kapacitetin e nevojshëm për të përmbushur në mënyrë profesionale detyrimet kontraktuale, duke siguruar një ekzekutim të qartë dhe efektiv të objektit të prokurimit. Përvoja në fushën specifike të prokurimit është element kyç për të garantuar qëndrueshmërinë ekonomike dhe teknike të ofertuesit. Ajo tregon aftësinë e operatorit për t'u përballur me sfidat e një kontrate të tillë, duke vërtetuar besueshmërinë dhe suksesshmërinë në përmbushjen e kontratave të ngjashme në të kaluarën. Në këtë mënyrë, kërkesa për personel të kualifikuar nuk është thjesht një formalitet, por një masë thelbësore që ofron siguri për përmbushjen e kontratës me standardet më të larta profesionale.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një staf teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, me këto kompetenca:

2 (dy) Teknik Audio

1 (nje) Elektracist per instalime

1(nje) Teknik Video

3 (tre) Teknik skene/ punime ne lartesi)

1 (një) IT

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme për periudhën e zbatimit të Kontratës/Marrëveshjes kuadër;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik
- Listëpagesat sipas formularit e Sig25 për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10. Formulari I vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Ky kriter siguron që operatorët të kenë jo vetëm personel teknikisht të kualifikuar, por edhe aftësi teknologjike të përparuara, të cilat janë thelbësore për suksesin e projektit dhe përmbushjen e qëllimeve të autoritetit kontraktues. Për më tepër, në një mjedis teknologjik gjithnjë në zhvillim, përfshirja e një specialisti IT brenda ekipit të operatorit ekonomik është një nevojë e domosdoshme për të siguruar që pajisjet teknologjike, rrjetet kompjuterike dhe sistemet e sofistikuar, të cilat mund të jenë të nevojshme për realizimin e kontratës, funksionojnë me efikasitet të lartë. Ky rol siguron zgjidhjen e shpejtë të problemeve të mundshme harduerike apo softuerike, duke kontribuar në efikasitetin operacionale dhe duke minimizuar rrezikun e ndonjë ndërprerje teknike gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.3 Për kryerjen e transportit të logjistikës, operatori duhet të disponojë 2 (dy) mjete tip kamion dhe 2 (dy) mjet transporti tip furgon të pajisur me dokumentacion si më poshtë:

- Certifikatë pronësie ose kontrate qira;
- dokument që vërteton regjistrimin e mjetit- Leje Qarkullimi;
- siguracionin e vlefshëm të mjetit (policën e sigurimit);
- çertifikatën e vlefshme të kontrollit teknik (SGS); -taksa vjetore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën. Ky kriter është vendosur me qëllim që të sigurohet se operatorët ekonomikë janë të pajisur me mjetet e duhura të transportit, si dhe kanë mundësinë për t’i vënë në dispozicion në çdo kohë, për të garantuar përmbushjen e suksesshme të objektit të kontratës. Kapaciteti i mjeteve të mëdha dhe të specializuara të transportit është thelbësor, duke marrë parasysh natyrën komplekse dhe përmasat e veçanta të kontratës, të cilat kërkojnë zgjidhje logjistike të avancuara dhe të mirëkoordinuara.

Numri dhe lloji i mjeteve të transportit janë përcaktuar jo vetëm duke u bazuar në eksperiencën e kaluar të realizimeve të ngjashme, por gjithashtu duke vlerësuar shtrirjen e gjerë gjeografike ku do të kryhen eventet dhe nevojën për lëvizjen efikase dhe të shpejtë të materialeve dhe pajisjeve mes njësisve vendore (bashkive) të ndryshme. Në këtë kontekst, transporti i sigurt dhe i shpejtë i mjeteve të nevojshme bëhet një komponent thelbësor për përmbushjen e kontratës brenda afateve dhe standardeve të kërkuara.

Për më tepër, duke qenë se këto evente do të realizohen në të njëjtën kohë në vende të ndryshme, nevojitet një koordinim i saktë logjistik që përfshin jo vetëm mjetet e duhura, por edhe kapacitetin për t'i menaxhuar ato me efikasitet. Një numër i pamjaftueshëm ose lloje të papërshtatshme të mjeteve mund të sjellin vonesa apo probleme në zbatimin e kontratës, gjë që mund të rrezikojë përmbushjen e suksesshme të saj. Për të realizuar këto detyra logjistike komplekse, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se posedojnë ose kanë akses të garantuar në pajisje dhe mjete të transportit të mëdha e të specializuara, në përputhje me kërkesat e kontratës. Dokumentet përkatëse që operatorët duhet të paraqesin ofrojnë një garanci të fortë për aftësinë e tyre teknike dhe logjistike për të përmbushur detyrimet kontraktuale, duke siguruar që ata disponojnë të gjitha asetet e nevojshme për të ofruar një shërbim të qëndrueshëm dhe cilësor.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të disponojë jo më pak se 20 punonjës të siguruar për çdo muaj për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.10. Formulari I vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Ky kriter synon të sigurojë që operatorët ekonomikë disponojnë një fuqi punëtore të mjaftueshme dhe të kualifikuar për të realizuar me sukses objektin e prokurimit, duke pasur në dispozicion një numër të përshtatshëm punonjësish në çdo moment gjatë periudhës së kontratës. Fuqia punëtore është një nga komponentët kryesorë për të garantuar që kontrata do të përmbushet brenda afateve të kërkuara dhe sipas specifikimeve të përcaktuara në Termat e Referencës, ku është përllogaritur numri minimal i nevojshëm i punonjësve për t'i bërë ballë detyrave komplekse të kontratës. Numri dhe stabiliteti i punonjësve në periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit janë tregues të qartë të aftësisë së operatorit për të përballuar detyra të shumta dhe sfida të mëdha, si në rastet e mbivendosjes së eventeve të mëdha që kërkojnë menaxhim të përkohshëm të burimeve njerëzore, ashtu edhe në rastet kur eventet zhvillohen në distanca të largëta gjeografike. Kjo garanci njerëzore i ofron autoritetit kontraktues një nivel të lartë besueshmërie, duke siguruar që operatori ekonomik mund të përballojë një gamë të gjerë sfidash operacionale, përfshirë ngarkesat e shumta të punës dhe

situatat ku kërkohen burime të shpërndara njëkohësisht në disa lokacione. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve, i cili është një kërkesë e parashikuar nga Kodi i Punës dhe legjislacioni tatimor dhe i sigurimeve shoqërore, është jo vetëm një detyrim ligjor, por gjithashtu një garanci për qëndrueshmërinë e punonjësve të punësuar nga operatori. Vërtetimi i siguruar nga administrata tatimore, së bashku me listëpagesat për periudhën përkatëse, ofron provën e qartë se operatori ka kapacitetet e nevojshme për të mbajtur dhe menaxhuar një fuqi punëtore të qëndrueshme, të kualifikuar dhe të përvojë të gjatë në fushën e kërkuar. Kjo është thelbësore për përmbushjen e suksesshme të kontratës dhe për të siguruar cilësi të lartë në ofrimin e shërbimeve. Për më tepër, ky kriter ndihmon në kufizimin e problematikave sociale dhe adresimin e informalitetit në tregun e punës, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi të punës më të rregullt dhe të qëndrueshëm. Punësimi i një numri të mjaftueshëm punonjësish jo vetëm që përmirëson besueshmërinë e operatorëve ekonomikë si një nga kërkesat thelbësore të kualifikimit, por gjithashtu siguron që detyrimet ligjore dhe shoqërore të përmbushen në mënyrë të rregullt.

2.3.5 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001:2015 (Sistemi I menaxhimit të cilësisë) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- ISO 45001: 2018 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 27001:2013 Çertifikaten e sistemit të Sigurisë së Informacionit e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Duke marrë parasysh natyrën specifike, vendndodhjen dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurimet, është thelbësore që operatorët ekonomikë të jenë të aftë të zbatojnë standarde të larta cilësie në çdo aspekt të veprimtarisë së tyre. Veçanërisht, menaxhimi i cilësisë, siguria e informacionit dhe siguria dhe shëndeti në punë janë faktorë të pazëvendësueshëm për të siguruar që projekti jo vetëm të përmbushet me sukses, por edhe në përputhje me të gjitha rregullat e kërkuara të sigurisë dhe cilësisë. Këto sisteme menaxhimi përbëjnë një bazë solide mbi të cilën mbështetet cilësia e punimeve dhe operacioneve të kryera nga operatori ekonomik, duke garantuar që kontrata do të përmbushet sipas pritshmërive më të larta.

Certifikatat përkatëse, që lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës, ofrojnë një garanci të qartë për autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë janë plotësisht të aftë për të kryer detyrat e kërkuara në përputhje me standardet e larta të cilësisë, sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit. Referuar nenit 79 të ligjit 162/2020, është e parashikuar qartë që autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata të lëshuara nga organe të pavarura, të cilat dëshmojnë përputhshmërinë e operatorit me këto standarde ndërkombëtare të cilësisë. Ky kusht rrit sigurinë se operatori jo vetëm që është teknikisht i aftë, por gjithashtu i përkushtuar për të respektuar standardet ligjore dhe praktikat më të mira në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Për më tepër, ekzistenca e këtyre sistemeve menaxhimi tregon aftësinë e operatorit për të menaxhuar me efikasitet jo vetëm procesin e ekzekutimit të kontratës, por edhe për të garantuar që stafi teknik dhe punonjësit do të ndjekin praktika të sigurta dhe të qëndrueshme gjatë realizimit të projekteve. Kjo përfshin jo vetëm sigurimin e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve, por edhe zbatimin e standardeve të larta për mbikëqyrjen e montimit, çmontimit dhe pastrimit të vendeve të eventeve, në mënyrë efikase dhe në përputhje të plotë me detyrimet ligjore. Kjo siguri shtesë është e një rëndësie të veçantë për autoritetin kontraktor, pasi ajo minimizon rreziqet që lidhen me cilësinë dhe sigurinë e punës, ndërkohë që ofron një garanci se operatori ka kapacitetin e nevojshëm për të përmbushur detyrimet kontraktuale edhe në situata komplekse apo të paparashikueshme. Kërkimi i këtyre certifikatave dhe ekuivalenteve të tyre kontribuon në një proces të sigurt, transparent dhe të besueshëm për përmbushjen e kontratës, duke garantuar standardet më të larta të cilësisë dhe sigurisë në çdo hap të procesit të realizimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë që disponojnë pajisjet teknike sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e kontrates me foto.

Shenim: Per zerat ne DST qe mund te jete paraqitur marke/brand, operatoret ekonomik mund te ofertojne ekuivalente te tyre gjate pergatitjes se ofertes ekonomike.

Argumentimi: Siç theksuam më lartë, për të realizuar me sukses kontratën, është thelbësore që operatorët ekonomikë të përmbushin plotësisht kapacitetet teknike të kërkuara, përfshirë pajisjet dhe asetet e tjera fizike. Këto kapacitete teknike nuk janë vetëm tregues të aftësisë së operatorëve për të kryer detyrat e caktuara, por gjithashtu garantojnë se ata janë në gjendje të përballojnë sfida të ndryshme që mund të dalin gjatë procesit të ekzekutimit të kontratës. Dokumentet konkrete që operatorët duhet të paraqesin sigurojnë transparencë dhe besueshmëri në lidhje me disponueshmërinë e këtyre kapaciteteve, duke u bazuar në kërkesat specifike të projektit. Pajisjet dhe mjetet teknike janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe përmasat e kontratës. Ato përfaqësojnë një garanci se operatori ekonomik ka kapacitetet e nevojshme jo vetëm për të realizuar punimet sipas standardeve të larta të cilësisë, por edhe për të përballuar ngarkesat specifike që mund të shfaqen gjatë periudhës së kontratës. Këto kapacitete teknike janë thelbësore për të adresuar situata ku kërkohen porosi specifike nga Autoriteti Kontraktor, qofshin ato të menjëhershme apo të përkohshme. Prania e pajisjeve të mjaftueshme dhe të përshtatshme garanton që operatori ekonomik mund të përmbushë edhe kërkesa të njëkohshme apo të papritura, duke ofruar një fleksibilitet të rëndësishëm për menaxhimin e proceseve komplekse dhe mbivendosjen e detyrave.

Për më tepër, kapacitetet teknike përfaqësojnë jo vetëm aftësitë e operatorit për të kryer detyrat në mënyrë të përshtatshme, por gjithashtu aftësinë e tij për të mbajtur një nivel të lartë të organizimit profesional dhe teknik. Kapacitetet organizative të operatorit, të demonstruara përmes menaxhimit të pajisjeve dhe aseteve fizike, sigurojnë që kontrata do të zbatohet brenda afateve të caktuara dhe me burimet e nevojshme, duke shmangur vonesat apo problemet teknike që mund të rezultojnë nga mungesa e pajisjeve të përshtatshme. Këto kapacitete teknike dhe profesionale janë dëshmi e qartë për autoritetin kontraktor se operatori është në gjendje të përmbushë kontratën në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të përcaktuara, duke përfshirë çdo lloj kërkesë të veçantë apo porosi shtesë që mund të lindë gjatë zbatimit të kontratës. Prania e dokumenteve që vërtetojnë këto kapacitete i siguron autoritetit që operatori jo vetëm që është i kualifikuar, por gjithashtu plotësisht i aftë për të përballuar çdo sfidë apo detyrë që mund të kërkohej në mënyrë të menjëhershme nga ana e Autoritetit Kontraktor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e references, specifikimet teknike janë pjese e DST.